



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE  
KËSHILLI DREJTUES**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.,

Tiranë më \_\_\_\_\_. \_\_\_\_ 2025

**V E N D I M**

**Nr.22, datë 03.11.2025**

**PËR**

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURËN DHE MËNYRËN E  
LLOGARITJES SË NIVELIT TË PAGESAVE VJETORE QË KRYHEN NË AKEP PËR  
MBIKËQYRJEN E TREGUT TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE  
SHËRBIMEVE POSTARE”**

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), me pjesëmarrjen e:

|             |                       |                |
|-------------|-----------------------|----------------|
| <b>Z.</b>   | <b>Gentian Sala</b>   | <b>Kryetar</b> |
| <b>Znj.</b> | <b>Edlira Dvorani</b> | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Lorenc Bako</b>    | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Bleron Dokle</b>   | <b>Anëtar</b>  |
| <b>Z.</b>   | <b>Armer Juka</b>     | <b>Anëtar</b>  |

dhe sekretare znj. Xhilda Hoxha, në mbledhjen e datës 03 nëntor 2025, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Rregullores së Brendshme për “Funksionimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare”, miratuar me Vendimin nr. 7, datë 16.02.2017, të Këshillit Drejtues të AKEP, të ndryshuar, shqyrtoi çështjen me objekt:

- *Miratimin e rregullores “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP, për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.*

**BAZA LIGJORE:**

1. Pika 1 e nenit 17, pika 1, gërma “a” e nenit 19, nenet 20 dhe 36 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”;

2. Nenet 27 dhe 31 të ligjit nr. 46/2015 “Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë”.

### **K Ë S H I L L I D R E J T U E S:**

Nga shqyrtimi i materialit shkresor të përbërë si më poshtë:

1. Projektvendimi i formatuar dhe arsyetuar;
2. Relacioni shoqërues i projektvendimit;
3. Komentet e palëve të interesuara të paraqitura gjatë Këshillimit Publik;
4. Dokumenti përfundimtar: Rregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”,

si dhe nga diskutimet në mbledhje mbi çështjen dhe duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

### **V Ë R E N:**

1. Këshilli Drejtues i AKEP me vendimin nr. 12, datë 27.08.2025, ka miratuar dokumentin për këshillim publik, projektregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.
2. Dokumenti për këshillim publik, projektregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, u miratua nga AKEP duke u bazuar në përcaktimet e nenit 17, 19 dhe 20 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, si dhe nenit 27 të ligjit nr. 46/2015, i cili përcakton pagesën e mbikëqyrjes së tregut të komunikimeve elektronike dhe tregut të shërbimit postar, modalitetet e llogaritjes së kësaj pagese, si dhe afatet e pagesës të saj nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe ofruesit e shërbimit postar.
3. Dokumenti për këshillim publik, projektregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, u publikua në faqen e internetit të AKEP, më datë 26.08.2025, dhe periudha e këshillimit publik përfundoi më datë 26.09.2025.
4. Në përfundim të procesit të këshillimit publik, pranë AKEP janë depozituar me shkresën nr. 1388 prot., i AKEP, datë 29.09.2025, komente nga sipërmarrësi “One Albania” sh.a.
5. AKEP, pas marrjes dhe vlerësimit të komenteve të këtij sipërmarrësi, ka përgatitur rregulloren “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”.

6. Dokumenti i AKEP, rregullore “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”- Dokumenti përfundimtar:

- përmban qëndrimin e AKEP, mbi komentet dhe sugjerimet e palëve të interesuara të dhëna gjatë procesit të këshillimit publik.
- nga pikëpamja e ligjshmërisë është konform me përcaktimet ligjore të neneve 17, 18, 20 dhe 36 të ligjit nr. 54/2024 dhe nenet 27 dhe 31 të ligjit nr. 46/2015,

### **P Ë R K Ë T O A R S Y E:**

Në mbështetje të pikave 1, të neneve 14 dhe 15 të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli Drejtues i AKEP,

### **V E N D O S I:**

1. Të miratojë rregulloren “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky vendim dhe rregullorja “Për procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, të publikohen në faqen e internetit [www.akep.al](http://www.akep.al).
3. Rregullorja e AKEP nr. 20, datë 18.12.2015 “Mbi procedurën dhe mënyrën e llogaritjes së nivelit të pagesave vjetore që kryhen në AKEP për mbikëqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike dhe shërbimeve postare”, shfuqizohet.
4. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

|                     |                       |                     |                    |                   |
|---------------------|-----------------------|---------------------|--------------------|-------------------|
| <b>Kryetar</b>      | <b>Anëtar</b>         | <b>Anëtar</b>       | <b>Anëtar</b>      | <b>Anëtar</b>     |
| <b>Gentian Sala</b> | <b>Edlira Dvorani</b> | <b>Bleron Dokle</b> | <b>Lorenc Bako</b> | <b>Armer Juka</b> |